



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë E-mail: klsh.org.al; site.klsh.org.al

Nr. 923/___Prot.

Tiranë, më 27.02.2020

V E N D I M

Nr 13 date 27.02.2020

MBI

AUDITIMIN FINANCIAR, TË USHTRUAR NË BASHKINË RROGOZHINË

PËR PERIUDHËN 01.01.2018 – 31.10.2019.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Rrogozhinë, për auditimin financiar, për periudhën 01.01.2018-31.10.2019, pavarësisht përpjekjeve pozitive të drejtuesve të Bashkisë Rrogozhinë, u konstatuan deviacione materiale të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare referuar kuadrit rregullator në fuqi.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamenti i Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, të miratuar në datën 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

VENDOSA:

I. Të miratoj "Raportin Përfundimtar të Auditimit Financiar të ushtruar në Bashkinë Rrogozhinë", sipas programit të auditimit nr.923/1 prot., datë 14.11.2019, për veprimtarinë nga data 01.01.2018 deri më datën 31.10.2019.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë Rrogozhinë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Rrogozhinë për vitin ushtrimor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimit të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe zërat në pasqyrat financiare, bazuar në vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar/pakualifikuar me theksim çështjeje¹:

Ne japim opinionin tonë se përveç çështjeve të theksuara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar”, pasqyrat financiare:

- *janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;*
- *pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;*
- *janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.*

Baza për opinionin e pamodifikuar me theksim çështjeje:

Përgjegjësitë tona, si auditues në referencë të standardeve ndërkombëtare të auditimit, janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Rrogozhinë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare nën juridiksion, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700)

Ne i tërheqim vëmendjen subjektit të audituar për çështjet e theksuara më poshtë, të cilat nuk janë thelbësore dhe me ndikim në pasqyrat financiare:

Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” është nënvlerësuar për 1,257,329 lekë

Llogaria 1013, “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ” është nënvlerësuar për 1,257,329 lekë

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar për 62,051,960 lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është nënvlerësuar për 21,303,308 lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është mbivlerësuar për 4,204,992 lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është nënvlerësuar për 8,832,400 lekë

¹ *Opinion i pamodifikuar/pakualifikuar me theksim çështjeje. Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare. Theksimi i çështjes Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion pa rezerve, në rast se kjo keqinterpretohet si rezervë. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si “theksimi i çështjes” përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit.*

Llogaria 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është mbivlerësuar me 8,832,400 lekë
Llogaria 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është nënvlerësuar me 4,204,992 lekë
Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është nënvlerësuar me 21,303,308 lekë

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Rrogozhinë.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Rrogozhinë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesit të Kontrollit të Lartë të Shtetit

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Rrogozhinë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700)

A- MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi:

- Në drejtim të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë Rrogozhinë nga auditimi rezultoi se nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur në dy komponentë të tij, mjedisi i kontrollit dhe në aktivitetet e kontrollit. Kjo për faktin se nuk ka patur rregullore të brendshme të funksionimit për periudhën objekt auditimi. Rregullorja “**Për organizimin, funksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Rrogozhinë**”, e cila është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.5311, datë 06.12.2020, pra jashtë periudhës së auditimit. Nga auditimi rezultoi se në kundërshtim me ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nuk ka kod etik të veçantë; manuale mbi procedurat për operacionet kryesore si dhe nuk ka rregulla të brendshëm që garantojnë sigurinë e sistemit IT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën A faqe 24-25 të Raportit të Auditimit, dhe aneks A)

Pavarësisht se struktura e Auditit të Brendshëm ka qenë pjesë e organigramës së Bashkisë, ky sektor nuk ka funksionuar deri në shtator 2019, me arsyetimin e mungesës së personelit, pra ky sektor nuk ka funksionuar. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka patur **manual specifik** të Auditit të Brendshëm **si dhe Kartë të Auditit të Brendshëm**, ato janë hartuar në muajin shtator 2019.

(Trajtuar në pikën A faqe 25-26, të Raportit të Auditimit, dhe aneks A).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Rrogozhinë të merren masa për:

- hartimin e kodit etik;
- hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore
- kryerjen e vlerësimeve periodike të stafit;
- përcaktimin e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT

Deri në korrik 2020.

1.2 Rekomandimi:

Nga ana e Bashkisë Rrogozhinë të merren masa për vënien në funksion të Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procedurën e diskutimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve: Buxheti për vitin 2019 nuk është përgatitur dhe miratuar brenda datës 25 dhjetor të vitit paraardhës, nuk është paraqitur për miratim brenda muajit nëntor të vitit buxhetor nga kryetari i njësisë të qeverisjes vendore në Këshillin Bashkiak, nuk ka analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti. Planifikimi i të ardhurave është bërë me rezervë, duke ulur në mënyrë artificiale nivelin e mosrealizimit të tyre, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016,

Nga të ardhurat e veta janë paguar 45 punonjës më shumë se totali para reformës territoriale, të punësuar kryesisht në shërbimet publike dhe në administratë. Efekti financiar i 45 punonjësve është rreth 18 milion lekë shpenzime më shumë nga të ardhurat e veta.

Për rastet e investimeve nga të ardhurat, prokurimet, (përveç shpenzimeve operative ose blerjeve të vogla) janë bërë pa pasur fonde në dispozicion, vetëm në bazë të planifikimit.

Nga auditimi rezultoi se vetëm 30% e investimeve është mbuluar nga të ardhurat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 27-29, të Raportit të Auditimit, dhe aneks B).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, për vitet në vazhdim, të marrë masa për diskutimin e buxhetit të vitit pasardhës në këshillin bashkiak brenda muajit nëntor të vitit buxhetor dhe për miratimin përfundimtar të tij jo më vonë se data 25 dhjetor.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga administrata e Bashkisë Rrogozhinë nuk është paraqitur në të gjitha rastet në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacioni justifikues i shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.

Për procedurat e raportuara si të prapambetura nuk është ruajtur plotësisht radha e financimit. Deri në datën 31.10.2019, Bashkia Rrogozhinë ka pasur 134,171,762 lekë detyrime të papaguara ndaj të tretëve, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet.

Nga administrata e Bashkisë Rrogozhinë nuk janë zhvilluar procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

(Trajtuar në pikën B faqe 27-29, të Raportit të Auditimit, dhe aneks B).

3.1 Rekomandimi: Sektori i Financës Bashkia Rrogozhinë, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre për vlerën 134,171,762 lekë.

Të respektojë radhën e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura dhe të zhvillojë procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e këtyre detyrimeve. Për rastet kur nga Bashkia Rrogozhinë ka pretendime ose kontestime, të fillojnë procedurat gjyqësore.

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak.

4. Gjetje nga auditimi: Vlerat e llogarive **210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, dhe 215 “Mjete transporti”** në Pasqyrën e Pozicionit Financiar 2018, është marrë bruto nga pasqyrat financiare të njërive administrative në 2015 dhe nuk është specifikuar në mënyrë analitike, por thjesht janë bërë shtesat e pakësimet për vitet 2016, 2017 dhe 2018 pas centralizimit të kontabilitetit të komunave në Bashkinë Rrogozhinë.

Gjatë vitit 2018 janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë, **210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”,** dhe aktivet afatshkurtra si dhe për këto llogari, si dhe llogarinë **214 “Instalime teknike, makineri e pajise”** dhe llogarinë **215 “Mjete transporti”** nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

Me urdhrin nr.57 datë 15.11.2018 është ngritur komision për inventarizimin e aktiveve për vitin 2018 duke mos i specifikuar cilat aktive por duke realizuar inventarizimin vetëm për llogaritë 214 Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune, 215 Mjete transporti dhe 218 Inventar ekonomik (bazuar kjo në proces verbalet e inventarizimit të cilët janë përpiluar vetëm për materialet, inventarët e imët, inventarin ekonomik dhe instalimet teknike. Janë përjashtuar nga inventarizimi përkatësisht, **210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”,** dhe aktivet afatshkurtra.

Veprimet e mësipërme, na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për sa i përket zërave **210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** dhe aktivet afatshkurtra dhe për pasojë të mos japim dot një opinion mbi *plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë* e këtyre vlerave në kontabilitet.

Gjithashtu në këtë strukturë vihet re se nuk ka një sektor të veçantë apo një zyrë të menaxhimit të aseteve, por është mbuluar nga një specialist për vlerësimin financiar të aseteve vendore, pjesë e sektorit të menaxhimit financiar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6 dhe nenin 8 pika d), udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat nga 26-30, si dhe pikën 74 si dhe 9 pika f) të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikat 9, 10, 11, 13, 14 dhe 21 të VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C/1.1, faqe 40-41 të Raportit të Auditimit, dhe aneks C).

4.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës së Bashkisë Rrogozhinë, të merren masa për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më

sot, përkatësisht për zërat; **210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtim e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.**

4.2 Rekomandimi Nga ana e Bashkisë Rrogozhinë të merren masa të menjëhershme që nën strukturën organizative të ngrihet një zyre apo sektor i veçantë i administrimit të aseteve në përputhje me kërkesat ligjore siç përcaktohet dhe në VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore “në pikat 9, 10 11, 13 ,14 dhe 21 te saj.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i financës së Bashkisë Rrogozhinë nuk është ngarkuar në kredi të llogarisë **219 “Amortizim i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”** dhe në debi të Llogarisë **1013, “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ”** vlera 1,257,329 lekë për vitin 2015 përkatësisht për llogarinë **213 Rruge, rrjete, vepra ujore”**. Gjithashtu për çdo aktiv afatgjatë material (*212 Ndërtim e Konstruksione, 213 Rruge, rrjete, vepra ujore, 214 Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune, 215 Mjete transporti dhe 219 Inventar ekonomik*) aplikimi i normës së amortizimit vjetor është bërë mbi koston e aktivitetit dhe jo mbi vlerën kontabël neto. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 4; Urdhri nr.64 i Ministrit të Financave datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 në pika nr.30 dhe nr.40.

Aktivitet Afatgjatë Financiare me llogarinë **26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”**, paraqitet në vlerën zero në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2018 edhe pse Bashkia Rrogozhinë zotëron 100% aksione në pjesëmarrje në “Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë” sh.a me vlerë **62,051,960 lekë**

(Më hollësisht trajtuar në pikën C/1.1, faqe 40-44 të Raportit të Auditimit, dhe aneks C).

5.1 Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Rrogozhinë të merren masa për sistemimet në kontabilitet të fondit të amortizimit si dhe Vlera Kontabël Neto të secilit aktiv, rillogaritur këtë fond amortizimi me bazën e duhur të amortizimit {(kosto – amortizimi i akumuluar) x % amortizimit të aktivitetit} si dhe te sistemohen përkatësisht llogaria **1013, “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ”** dhe llogaria **213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”** për një vlerë totale prej **1,257,329 lekë**.

5.2 Rekomandimi: Në mbështetje të zyrës së aseteve, duke qenë se nuk ka pasur një evidencë të vlerave kontabël të aseteve nën administrimin e bashkisë, nga ana e Bashkisë Rrogozhinë të merren masa që të bëhet një vlerësim i tyre në mënyrë që në kontabilitet të paraqitet vlera e drejtë e tyre.

5.3 Rekomandimi Nga Bashkia Rrogozhinë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë” sh.a me vlerë kontabël **62,051,960 lekë** në llogarinë **26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”**.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”**, e cila përbëhet nga fatura të pa likuiduara të vitit **2018**, është nënvlerësuar me **21,303,308 lekë** duke mos paraqitur si detyrime fatura të likuiduara në 2019 me datë emetimi në vitin 2018, pra duke mos zbatuar parimin e të drejtave të konstatuara në kontabilitet me justifikimin e mungesës së fondeve buxhetore. Nga ana tjetër kjo llogari është mbivlerësuar për më tepër me 4,204,992 lekë fatura mos likuidimi i të cilave nuk ka ardhur për shkak të mungesës së fondeve buxhetore. Gjithashtu llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është nënvlerësuar **8,832,400 lekë**, të cilat janë fatura të pa likuiduara përpara vitit 2018 kryesisht për blerje materiale që janë klasifikuar gabimisht në

llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe mos likuidimi i tyre ka ardhur për shkak të mungesës së fondeve buxhetore.

Llogaria 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2018 me vlerë totale **26,404,313 lekë** është e përbërë nga fatura të pa likuiduara përpara vitit 2018 kryesisht për blerje materiale në vlerë 8,832,400 lekë dhe fatura të pa likuiduara gjatë vitit 2018 në vlerën 17,571,913 lekë. Pra kjo llogari është mbivlerësuar me **8,832,400 lekë**, fatura këto që duhet të ishin paraqitur në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Gjithashtu llogaria 401 508 është nënvlerësuar me 4,204,992 lekë, fatura këto mos likuidimi i të cilave nuk ka ardhur për shkak të mungesës së fondeve buxhetore dhe janë paraqitur gabimisht në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6, 7, 9 dhe 10; ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 të Ministrisë së Financave, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42. (Trajtuar në pikën C/1.1, faqe 44-45, të Raportit të Auditimit, dhe aneks C).

- **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** nuk ka kundër parti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe të evidentohen veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Pra edhe faturat e gjendura nga data baza e thesarit për pagesat e vitit 2018, të cilat janë likuiduar në vitin 2019, janë fatura që, për shkak të mungesës së fondeve, nuk janë likuiduar si dhe nuk janë paraqitur si detyrime në llogarinë kreditore 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe për të njëjtën arsye, nuk e gjejmë as në llogarinë debitore 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Pra automatikisht kemi një nënvlerësim të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me **21,303,308 lekë**. Këto veprime bien në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C/1.1, faqe 46 të Raportit të Auditimit, dhe aneks C).

6.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Rrogozhinë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarive **467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vitin 2018.**

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1269/8 prot., datë 14.12.2018, rezultoi se:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 16 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 12 masa dhe janë në proces zbatimi 4 masa organizative.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 35 masa me vlerë 26.244.496 lekë, nuk janë pranuar 23 rekomandime në shumën prej 9,877,446 lekë, duke u pranuar 11 rekomandime në vlerën prej 14,367,050 lekë

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej 26.244.496 lekë:

në lekë:	
Deri më datën 30.11.2019 është arkëtuar	904,070
Kanë mbetur pa u arkëtuar:	25,340,426
Nga të cilat:	
Nuk pranohen 23 rekomandime:	9,877,446
Prej tyre:	

4 raste për shpenzime akomodim dhe transporti futbollistësh:	4,641,218
16 raste tërheqje karburanti nga punonjësit e administratës:	4,825,124
3 raste për orët shtesë dhe shpenzime për produkte ushqimore:	411,104
Në proces gjyqësor 4 subjekte:	13,190,393

b/1. Vlera e debitorëve në bilancin e audituar ka qenë 17,522,133 lekë për vitin 2016. Për vitin 2017 vlera e debitorëve është bërë 8,722,363 lekë. Shuma e debitorëve të dala nga auditimi i KLSH-së në vlerë 26,244,496 lekë është kontabilizuar në llogarinë 423 në vitin 2018. Nga këto janë arkëtuar 907,070 lekë dhe gjendja e debitorëve më 30.10.2019 është në total për shumën 25,340,426 lekë.

- **Në lidhje me auditimin e para vitit 2017, rezultoi se Bashkia Rrogozhinë, nga 14 masa organizative ka zbatuar 4 masa, në proces 2 masa dhe pa zbatuar 8 masa. Nuk janë zbatuar masa nr. 1, për arkëtimin e shumës 5,370,986 lekë dhe shumës 21,012,041 lekë për subjektet debitorë; masa nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 për 22 subjekte të pa licencuara në shumën 607,160lekë.**

Nga 8 masa shpërblim dëmi nuk ka zbatuar 8 masa në shumën 5,660,962 lekë.

d.1. Mbi gjomat e rekomanduara IMTV.

Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë. Nga verifikimi rezultoi se 2 masa administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës punimesh nuk janë zbatuar (Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 47-48 të Raportit të Auditimit, dhe ankes D).

7.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, si masa shpërblim dëmi dhe masa organizative.

Menjëherë.

B- MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Rrogozhinë ka 188 biznese të vogla dhe 34 biznese të mëdha debitorë, për të cilat nuk janë zbatuar procedurat për regjistrimin në kontabilitet të bizneseve debitorë për periudhën para konsolidimit territorial, për taksat dhe tarifatat e familjarëve, si dhe vlera nga asetet e dhëna me qira.

1. Vlera totale e debisë për bizneset (detyrim + kamatë) është **26,630,638 lekë**, nga e cila nuk është kontabilizuar detyrimi për vitin 2019.

2. Vlera totale e debisë për 314 subjekte që kanë ushtruar aktivitet në periudhën 2011-2016 është **23,891,038 lekë**, e pa kontabilizuar.

3. Vlera totale e debisë për taksën e tokës është **99,599,062 lekë**, e pa kontabilizuar.

4. Vlera totale e debisë për taksat e tarifatat të familjarëve është **38,929,763 lekë**, e pa kontabilizuar.

5. Vlera totale e debisë (detyrim +kamatë) për kontratat e qirave është **970,963 lekë** e pa kontabilizuar.

Nga sektori i të ardhurave Bashkia Rrogozhinë nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë, duke ribërë njoftim vlerësimet tatimore vendore për të gjithë subjektet debitorë. Nuk janë zbatuar masa shtrënguese, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Bashkia Rrogozhinë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet.

Nuk është zhvilluar asnjë program, procedurë apo teknikë për evidentimin në terren dhe regjistrimin e bizneseve të të gjitha kategorive, sipas përcaktimeve në paketat fiskale të çdo viti, si p.sh. mjeteve të transportit, mjeteve lundruese, apartamenteve të cilët lëshohen për fjetje nëpërmjet internetit, etj., duke favorizuar evazionin dhe konkurrencën e pandershme për

hotelet, motelet, bujtinat etj. Veprime në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar” të Ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Nga auditimi u konstatua mungesë e marrëdhënieve dhe korrespondencës me institucionet e tjera, shtetërore apo private, me qëllim evidentimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe tarifore.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Sigurie mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

(Trajtuar në pikën B faqe 29-31, të Raportit të Auditimit, dhe aneks B).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë, të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të subjekteve debitore për taksat dhe tarifatat vendore dhe familjeve debitore për taksën e tokës dhe të ndërtesës, të kontabilizojë pjesën e pa kontabilizuar të këtyre detyrimeve dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e vlerave debitore nga personat përkatës juridikë ose fizikë dhe familjarët, duke zbatuar sipas rastit edhe masat shtrënguese, konkretisht:

- **Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare,** bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

- **Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit,** kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

- **Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat,** të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

- **Spektori i të ardhurave, në bashkëpunim me Njësitë Administrative,** të evidentojë listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

Për sa më poshtë:

1.Detyrimet në vlerën **26,630,638 lekë** për bizneset e vogla dhe të mëdha.

2.Detyrimet në vlerën **23,891,038 lekë** për 314 subjekte që kanë ushtruar aktivitet në periudhën 2011-2016 është.

3.Detyrimet për taksën e tokës në vlerën **99,599,062 lekë**, e pa kontabilizuar.

4.Detyrimet në vlerën **38,929,763 lekë** për taksat e tarifatat të familjarëve.

5.Detyrimet në vlerën **970,963 lekë** për kontratat e qirave.

1.2 Rekomandimi:

- Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Në qoftë se evidentohen diferenca të pa mbledhura për këto lloj taksash, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj, të

fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117 të Ligjit 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”.

- Bashkia Rrogozhinë, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës (Drejtoria Tatimore Rajonale, Qendra Kombëtare e Biznesit, etj.), dhe të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitete në territorin e saj. Bashkia Rrogozhinë, të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me QKB-në, QKL-në, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, ZVRPP-në, ALUIZNIN, etj, për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj. Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa për të evidentuar plotësisht dhe saktësisht të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi në territorin e saj.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se në Bashkinë Rrogozhinë, figurojnë edhe 6 subjekte të tjera të cilat kanë si objekt të aktivitetit të tyre tregtinë me pakicë të karburanteve, gazit natyror, lëndëve djegëse për popullatën, etj. Gjithashtu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet. Konkretisht, në VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015. Sipas bazës ligjore të mësipërme, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër.

Për subjektet që nuk ka informacion në Bashkinë Rrogozhinë supozohet se nuk kanë autorizim.

Nga llogaritja e gabuar ose nga mos llogaritja e detyrimit për shkak të mungesës së informacionit e për buxhetin e bashkisë Rrogozhinë është krijuar një e ardhur e munguar në vlerën **16,900,000 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 34-35, të Raportit të Auditimit, dhe aneks B).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë, Sektori i te ardhurave, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **16,900,000 lekë**, (sipas detajmeve në anekset bashkëlidhur), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. Gjithashtu, të verifikojë nëse edhe subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të licencohen apo të ndërpritet veprimtaria e tyre, sipas rastit.

2.2 Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për të krijuar një regjistër të posaçëm për këtë kategori biznesesh, por edhe regjistra të posaçëm për bizneset e tjera me natyrë specifike (si p.sh. mjete lundruese, automjete, subjekte që paguajnë rentën minerare, që përdorin pasuritë publike për grumbullimin e bimëve medicinale, peshkimin, etj).

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga pushteti vendor janë administruar mbi 150,000 m² plazhe, të cilat janë dhënë në përdorim të subjekteve të ndryshëm. Nga auditimi i kontratave me qira të plazheve, u konstatua se:

- nuk janë zbatuar kriteret e Ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, konkretisht, nuk është krijuar inventari i burimeve kryesore turistike të njësisë së qeverisjes vendore dhe inventari i sipërmarrjeve turistike në nivel vendor (Neni 19, pika a), b), etj.;

- nuk janë zbatuar kriteret e ndërtimit të strukturave akomoduese dhe rregullorja e miratuar me VKM (nenet 44 dhe 64)); si dhe neni 71, “Rastet e kundërvajtjeve administrative”, pika g): “ushtrimi i veprimtarisë pa kontratën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 64, dënohet me gjobë 200 000 lekë;”,

- nuk janë zbatuar kriteret e VKM-së nr. 321, datë 28.5.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, pika 2 dhe 9 të kreut II dhe pika 1 e kreut IV, si dhe kriteret e Shtojcës B-3 të kësaj VKM-je; të ndryshuara me VKM-në nr. 436, datë 20.5.2015, pika 2 dhe VKM-ja nr. 369, datë 18.5.2016, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” neni 4 “Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit”, pikat 4, 5, 7, 8, 9 dhe 10; neni 7 “Kritere të përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit”, pikat 1, 2 dhe 4; neni 8 “Rinovimi i kontratës”, pikat 2, 3 dhe 5; Shtojca 2 e kësaj VKM-je “Kontrata model për përdorimin e hapësirës së plazhit”, VKM-ja nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores “për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, neni 4 “Harta e përgjithshme për plazhet e lejuara”, pika 1, 2, 3 dhe 4; neni 5 “Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit”; neni 9 “Kritere të përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit”, pikat 1, 2 dhe 4, si dhe Shtojca 2 e kësaj VKM-je “Kontrata model për përdorimin e hapësirës së plazhit kontratë qiraje”.

- nga Këshilli Bashkiak është vendosur në mënyrë të gabuar mënyra e tarifimit “sezonal” për hapësirën e plazhit, pasi në bazë të akteve nënligjore të përmendura më sipër tarifimi duhet të bëhet në bazë mujore:

- **Për vitin 2018**, nga auditimi u konstatua se janë lidhur 31 kontrata, për një sipërfaqe prej afërsisht 64,811 m², janë vjelë të ardhura për një sipërfaqe prej 73,907 m², ndërkohë, sipas llogaritjes së sipërfaqeve në dispozicion, duhet të ishin kontraktuar një sipërfaqe prej 101,238 m², duke shkaktuar një diferencë prej 7,183,160 lekë.

- **Për vitin 2019**, nga auditimi u konstatua se janë lidhur 39 kontrata, për një sipërfaqe prej afërsisht **75,448 m²**, janë vjelë të ardhura për një sipërfaqe prej 83,739 m², ndërkohë, sipas llogaritjes së sipërfaqeve në dispozicion, duhet të ishin kontraktuar një sipërfaqe prej 117,106 m², duke shkaktuar një diferencë prej 7,183,160 lekë.

Diferenca totale për të dyja vitet është 12,649,200 lekë.

Përveç sa më sipër, nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e protokollit, u konstatuan disa kontrata, për të cilat nuk ka të dhëna nëse janë paguar detyrimet apo jo, në vlerën **620,000 lekë**, e cila është detyrim i pa arkëtuar dhe përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

Për subjektet të cilët kanë operuar si stacione plazhi, pavarësisht se kanë paguar detyrimet sikur të ishin kontraktuar, duhej t’u ishin vendosur penalitetet në formë gjobe, në vlerën 200,000 lekë secilit, në përputhje me nenin 71 pika g, të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, ku vlera prej **1,800,000 lekë** përbën **të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

Nga shqyrtimi i planimetrive, plan vendosjeve dhe hartave të disponueshme, u konstatua se në të gjitha rastet, distanca nga deti është lënë 20-25 m, ndërkohë që duhej lënë 7 m dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar pjesa e plazhit për përdorim nga publiku, e cila duhet të jetë perpendikular me vijën e ujit. Të ardhurat që duhet të merreshin nga sipërfaqja prej 13 metrash gjerësi, e shumëzuar me * 0 gjatësinë e plazhit të dhënë në përdorim, e cila nuk është llogaritur në detyrimin e subjekteve, përbën **të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë. Kështu, nqs llogaritim një vijë bregdetare me gjatësi 3,000 m (150,000

m²/50m), të shumëzuar me 13 m gjerësi e cila duhet të ishte llogaritur në kontratat e qirave (megjithëse në disa raste është 18 m ose më shumë), rezulton një sipërfaqe totale prej 39,000 m², e cila ka shkaktuar një mungesë tjetër të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë në vlerën totale **7,800,000 lekë**, e cila duhet të llogaritet më vetë për çdo subjekt nga personeli i Bashkisë Rrogozhinë dhe t'u njoftohet subjekteve që e kanë pasur në përdorim.

Për pothuajse të gjitha kontratat e lidhura, në projektet e ndërtimit dhe në planimetritë bashkëlidhur paraqiten struktura ndërtimesh të mirëfillta, me plinta, kolona betoni apo hekuri, të cilat normalisht duhet të ishin subjekt i tatimeve përkatëse për këto lloj ndërtimesh, si dhe duhet të kishin bërë pagesat përkatëse të detyrimeve që rrjedhin nga pagesa për pajisjen me leje ndërtimi, leje shfrytëzimi etj. Pa marrë parasysh klauzolat përkatëse për ndërtimet pa leje apo për ndërtimet në zona të mbrojtura (siç janë zonat bregdetare), mospagimi i këtyre tarifave për ndërtimet e bëra përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

Pavarësisht se nuk lejohet ndërtimi në këto zona me rëndësi kombëtare, në kushte ideale, nqs këto ndërtime do të ishin zhvilluar rregullisht dhe në përputhje me legjislacionin për ndërtimin, Bashkia Rrogozhinë do të kishte përfituar minimalisht **10,889,475 lekë**, si të ardhura nga ndërtimet, shumë e cila përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë. Vlerat e detyrimeve për ndërtimin janë marrë nga VKM-ja nr. 408, datë 13.05.2015, neni 27/1 për Mbikëqyrjen e Punimeve të Ndërtimit.

Gjithashtu, krahas detyrimeve që rrjedhin nga llogaritjet e gabuara të detyrimeve që rrjedhin, duke qenë se asnjë nga ndërtimet e bëra në bregdet dhe në plazhe nuk është hequr në zbatim të kriterëve ligjore përkatëse, këto sipërfaqe duhet të trajtohen si troje dhe të tarifohen si të tilla nga Bashkia Rrogozhinë, me vlerën 60 lekë në muaj për m². Për periudhën 2 vjeçare të auditimit, kjo vlerë përbën **të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë, në vlerën **5,137,200 lekë**.

Përfundimisht, nga kontratat e plazheve dhe ndërtimet e bëra në bregdet, për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë rezulton një **të ardhura të munguara** në vlerën **38,895,875 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 36-40, të Raportit të Auditimit, dhe aneks B).

3.1 Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **38,895,875 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve.

3.2 Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa, duke zhvilluar korrespondencën përkatëse me Ministrinë e Turizmit, për të verifikuar plotësinë e dokumentacionit, afatet kur janë lidhur kontratat e qerasë, sipërfaqet e plazheve në përdorim të publikut dhe ato në përdorim të subjekteve private. Për të gjitha plazhet me mangësi në dokumentacion, me mangësi në kushtet e sigurisë apo të stacionit të plazhit dhe për kontratat e lidhura jashtë afatit 31 mars, të fillojnë procedurat e anulimit si të jashtëligjshme dhe plazhet t'i kthehen publikut.

3.3 Rekomandimi: Për kontratat në vijim, procesverbali i dorëzimit të plazhit të bëhet në formën e një liste kontrolli, ku të përfshihen të gjitha kriteret detyruese dhe kufizuese për stacionin e plazhit, për sigurinë e njerëzve dhe për kryerjen e pagesave.

3.4 Rekomandimi: Nga Bashkia Rrogozhinë, të merren masa që në përfundim të sezonit turistik, plazhet të kthehen në gjendjen natyrale, duke larguar të gjitha stacionet e plazhit .

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R